

PROGRAMI I STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË
BACHELOR NË “TEKNOLOGJI INFORMACIONI”

Emërtimi akademik i studimit	Diplomë BACHELOR në “TEKNOLOGJI INFORMACIONI”
Statusi i Akreditimit të programit të studimit	AKREDITUAR me Vendim nr.43, datë 28.02.2025, Bordi i Akreditimit
Cikli i studimit	Bachelor
Emri dhe statusi i insitucionit	Universiteti “Eqrem Çabej”, Institucion Publik, i Akredituar,
Gjuha e përdorur në mësimdhënie/provime	Shqip
Kohëzgjatja zyrtare e programit të studimit	3 (tre) vite
Forma e studimit	Me kohë të plotë
Kushtet e pranimit	Pranimi i studentëve për këtë program studimi kryhet nëpërmjet Maturës Shtetërore (portali U-albania). Përlllogaritja 50% nota mesatare aritmetike e shkollës së mesme përfshirë dhe provimet e Maturës Shtetërore dhe 50% gruplëndët e përcaktuara nga fakulteti për disiplinat bërthamë (për të gjitha vitet ku shtrihet lënda).

OBJEKTIVAT DHE VEPRIMTARITË FORMUESE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Qëllimi i programit të studimit “*Teknologji Informacioni*” është të aftësojë studentët të përdorin sistemet hardware dhe software në një nivel të lartë profesional, të veprojnë si dizenjues, programues dhe mirëmbajtës të sistemeve kompjuterike, sistemeve digjitale, rrjeteve kompjuterike, sistemeve bazë kompjuterike dhe programuese, si dhe të administrojnë sistemet e bazave të të dhënave dhe sistemet e informacionit.

Ky program studimi do të përgatisë të diplomuarit për të hyrë si një fuqi aktive në industrinë kompjuterike për të zhvilluar software apo për të aplikuar teknologjinë kompjuterike në organizmat shoqërore.

Të diplomuarit do të fitojnë njohuritë teknologjike themelore të sistemeve kompjuterike, gjuhëve të programimit, aplikimeve kompjuterike dhe sistemeve të informacionit.

Industria kompjuterike ka qenë gjithmonë subjekt i ndryshimeve të shpejta, dhe në këtë mënyrë ne synojmë të përgatisim të diplomuar të aftë për t’iu përshtatur ndryshimeve që do të hasin gjatë karrierës së tyre në punë. Ky program lejon studentët t’ju përqasen teknologjive të informacionit nga një këndvështrim teknik, konstruktiv, konceptual, kritik apo informues dhe menaxhues organizativ.

Gjithë procesi akademik udhëhiqet nga disa objektiva të përcaktuara qartë duke synuar që studentët në fund të ciklit të studimit të kenë njohuritë e nevojshme:

- ✓ për të siguruar një themel të thellë në IT së bashku me aspektet praktike të disiplinës.
- ✓ për t’u përgatitur për pozicionin IT në një gamë të gjerë organizmash.
- ✓ për të siguruar njohuri të dizenjimit, zhvillimit, menaxhimit, integritetit dhe shpërndarjes së sistemeve kompjuterike.
- ✓ për t’u përgatitur që t’i përshtaten ndryshimeve teknologjike.
- ✓ për të sintetizuar eksperiencat si dhe për të gjeneruar ide.
- ✓ për të menduar në mënyrë krijuese, të komunikuar në mënyrë efektive, të gjykuar dhe arsyetuar logjikisht.
- ✓ për të operuar, zhvilluar, shfrytëzuar dhe menaxhuar në grup si dhe për të nxitur aftësitë ndërpersonale dhe komunikuese të tyre si profesionistë të teknologjisë së informacionit.
- ✓ për t’u bërë aktivë në sigurimin e zhvillimit të tyre profesional.
- ✓ për t’u përgatitur si specialistë të aftë dhe të motivuar për të punuar në komunitet në të gjitha zonat e rajonit dhe më gjerë, për të ndihmuar në zhvillimin e tyre, për të rritur cilësinë dhe efikasitetin e shërbimeve.

Figura profesionale bazë që formohet nëpërmjet këtij programi është ajo e specialistit të “*Teknologjisë së Informacionit*”.

Objektivat dhe aftësitë që ky program synon të arrijë me studentët që ndjekin këtë cikël studimi, do të sigurojnë një performancë të lartë në mjedisin në të cilin do të veprojnë si i punësuar në të ardhmen.

Për realizimin e këtyre objektivave, programi parashikon thellime në cikle më të larta si ato të Masterit Profesional, Masterit Shkencor, Doktoraturës.

VEPRIMTARITË FORMUESE

- 1. Lëndë të formimit të përgjithshëm** (*Analizë matematike 1; Analizë matematike 2; Algjebër; Strukturë të dhënash; Sisteme operative*) (Kredite 30)
- 2. Lëndë të formimit karakterizues** (*Fizikë; Hyrje në Sisteme Programimi; Arkitekturë & Organizim Kompjuteri; Programim 1; Analizë matematike 3; Matematikë diskrete; Probabilitet & Statistikë; Programim2; Analizë numerike; Programim Web; Data Mining; Bazë të Dhënash; Rrjete Kompjuterike; Inteligjencë Artificiale*) (Kredite 96)
- 3. Lëndë integruese** (*Dizenjim & Analizë Algoritmash; Programim Object Oriented; Lëndë me zgjedhje*) (Kredite 19)
- 4. Lëndë me zgjedhje** (*Teori Grafesh; Gjuhë Assembly; Kurs special në Matematikë; Gjeometri e Lartë; Shkrim dhe Menaxhim; Projektsh Software Engineering; Machine Learning; Linus OS; Kurs special në Informatikë*) (Kredite 18)
- 5. Lëndë të formimit plotësues** (*Gjuhë e huaj; Siguri e Sistemeve Informatike; Praktikë profesionale*) (Kredite 21)
- 6. Përgatitje punim diplome** (Kredite 8)

SKEMA E VLERËSIMIT

Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistem notash nga 4 deri në 10, ku notat kanë kuptimin e mëposhtëm: 1-4 (mbetës), 5 (mjaftueshëm), 6 (kënaqshëm), 7-8 (mirë), 9 (shumë mirë), 10 (shkëlqyer). Gjatë provimit aplikohet një sistem pikësh, rezultatet e të cilave konvertohen në nota bazuar në skemën e mëposhtme:

NOTA	4 (katër)	5 (pesë)	6 (gjashtë)	7 (shtatë)	8 (tetë)	9 (nëntë)	10 (dhjetë)
PIKËT	0 - 44 pikë	45-54 pikë	55-64 pikë	65-74 pikë	75 – 84 pikë	85 – 94 pikë	95 – 100 pikë

MUNDËSIA PËR STUDIME TË MËTEJSHME

Diploma e ciklit të parë Bachelor në “**Teknologji Informacioni**” është ura lidhëse e zhvillimit të mëtejshëm akademik dhe profesional drejt cikleve më të larta të studimit. Kurrikula është e dizenuar në mënyrë të tillë që të ofrojë formate fleksible të të mësuarit duke u thelluar në specializime të mëtejshme.

Bazuar në kriteret e vendosura nga Njësia Bazë, sikurse edhe orientimi dhe preferenca e studentit, mbarimi i këtij cikli jep mundësinë për vazhdimin e studimeve në ciklin e dytë, në programe si: Master Profesional ose i Shkencave në fushat e Teknologjisë së Informacionit.

Pas mbarimit të këtij cikli studimi, studentëve do t’u hapen mundësitë për punësim më të sigurtë dhe për studime të mëtejshme, duke avancuar dijet e tyre në aspekte teorike dhe ato praktike.

Ky program studimi synon që të diplomuarve t’ju jepet mundësia të zhvillojnë kërkime shkencore në fushat e TIK.

MUNDËSITË E PUNËSIMIT DHE KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

Gjithnjë e më shumë tregu i punës po kërkon specialistë /ekspertë / mësues në fushat e Teknologjisë së Informacionit. Për këtë arsye, synimi i programit të studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni” është përgatitja e të diplomuarve të cilët do të plotësojnë kërkesën në rritje për këto pozicione që i kërkon tregu i punës.

Në këtë mënyrë, këta të diplomuar mund të punësohen në :

1. Administrator sistemi, mirëmbajtës dhe ekspert mbështetës i rrjetave kompjuterike, databazave, zhvillues programesh, dizenjues WEB-i;
2. Administratën publike;
3. Ndërmarrje të ndryshme ekonomike;
4. Institucione bankare, shëndetësore, telekomunikacion, etj;

5. Korporatat e telefonisë mobile dhe kompanitë e ndryshme;

Studenti fiton kompetenca që u përshtaten kërkesave gjithnjë e në rritje për kapacitete profesionale të kualifikuara, duke bërë të mundur krijimin e mundësive për studentët për punësim të përhershëm në tregun vendas dhe atë jashtë vendit.

PLANI MËSIMOR
I PROGRAMIT TE STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË
BACHELOR NË “TEKNOLOGJI INFORMACIONI”

Nr.	LËNDËT MËSIMORE	FORMA E VLERËSIMIT	KREDITET (ECTS)
VITI I			
1.	ANALIZË MATEMATIKE 1	Provim	6
2.	ANALIZË MATEMATIKE 2	Provim	6
3.	ALGJEBËR	Provim	6
4.	FIZIKË	Provim	11
5.	HYRJE NË SISTEME PROGRAMIMI	Provim	6
6.	ARKITEKTURË & ORGANIZIM KOMPJUTERI	Provim	6
7.	PROGRAMIM 1	Provim	7
8.	DIZENJIM & ANALIZË ALGORITMASH	Provim	7
9.	GJUHË E HUAJ	Provim	5
VITI II			
10.	STRUKTURË TË DHËNASH	Provim	6
11.	SISTEME OPERATIVE	Provim	6
12.	ANALIZË MATEMATIKE 3	Provim	6
13.	MATEMATIKË DISKRETE	Provim	6
14.	PROBABILITET & STATISTIKË	Provim	6
15.	PROGRAMIM 2	Provim	12
16.	ANALIZË NUMERIKE	Provim	6
17.	PROGRAMIM OBJECT ORIENTED	Provim	6
18.	LËNDË ME ZGJEDHJE	Provim	6
VITI III			
19.	PROGRAMIM WEB	Provim	6
20.	DATA MINING	Provim	6
21.	BAZË TË DHËNASH	Provim	6
22.	RRJETE KOMPJUTERIKE	Provim	6
23.	INTELIGJENCË ARTIFICIALE	Provim	6
24.	LËNDË ME ZGJEDHJE	Provim	6
25.	SIGURI E SISTEMEVE INFORMATIKE	Provim	12
26.	PRAKTIKE PROFESIONALE	Praktikë	4
27.	PROVIM I PËRGJITHSHËM PËRFUNDIMTAR/ PUNIM DIPLOME		8